



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për :	Ragip Begaj, Kryetar i Komunës së Malishevës Aziz Thaçi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Malishevës	
Cc:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Ivan Todosijević, Ministër i MAPL-së Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së	
Nga:	Shkelqim Jakupi, U.D Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave MAPL	Data 11.05.2017
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së Vendimit të Kuvendit të Komunës së Malishevës	Nr. 020-709
Lloji i aktit	Vendim	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim Nr. 02/131 për Dhënien e Pronës në shfrytëzim afatshkurtër së Paluajtshme të Komunës së Malishevës, pishinës publike në Fshatin Banjë
I miratuar më datë: 28.04.2017
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 08.05.2017

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës **është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi** dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Za:	Ragip Begaj, gradonačelnik opštine Mališevo Aziz Thaçi, predsedavajući Skupštine opštine Mališevo	
Kopija:	Jedinica za upravljanje dokumentima u MALS Jedinica za upravljanje dokumentima u opštini	
Preko:	Ivan Todosijević, ministar MALS-a, <i>hes: Ragip Begaj</i> Rozafa Ukimeraj, generalni sekretar MALS-a	
Od:	Shkelqim Jakupi, v.d. rukovodioca pravnog odeljenja i monitorisanje opština, MALS <i>Ken Hekaj</i>	Dana: 11.05.2017. Br. 020-709
Predmet:	Potvrda zakonitosti odluke Skupštine opštine Mališevo.	
Vrsta akta:	Odluka	

Poštovani gradonačelnice,
Poštovani predsedavajući,

U skladu sa Uredbom Vlade Republike Kosova br.01/2016 za administrativno razmatranje opštinskih akata, i na osnovu zakonskih nadležnosti ministarstva, određenim osnovnim zakonima i Vladinom Uredbom br.02/2011 o poljima administrativne odgovornosti kabineta premijera i ministarstva, odeljenju za pravna pitanja i monitorisanje opština Ministarstva administracije lokalne samouprave je dostavljen sledeći opštinski akt za obavezno razmatranje zakonitosti, onako kako se predviđa članom 81 Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi:

Odluka br.02/131 za davanje nepokretne imovine opštine Mališevo na kratkoročno korišćenje, javnom bazenu u selu Banje.
Usvojena dana: 28.04.2017. godine
Dostavljena MALS-u za razmatranje dana: 08.05.2017. godine

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog opštinskog akta, ceni da je opštinski akt u skladu sa odredbama zakonodavstva na snazi i kao takav može proizvoditi pravni efekat. Ministarstvo administracije lokalne samouprave, ostaje na raspolaganju opštine za bilo kakvo dalje objašnjenje u vezi sa ovom procenom.



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

HYRËSE-ULAZINA-INCOMING			
REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO / KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË			
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal / Ministarstvo Lokalne Samouprave / Administration of Local Government / Ministry of Local Government Administration			
Data / Datum / Date		08.05.2017	
Niveli organizativ / Struktura / Structure			
- 7 - 020-709			

Kuvendi i Komunës
Nr. 02/
Datë: 05.05.2017

PRAN: 05.05.2017
ACC: 05.05.2017
PRM: 05.05.2017
Nr No: 02/431

Në bazë të nenin 12 paragrafi 12.2 shkronja d, nenin 17, nenin 40, të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, bazuar në nenin 5 të Ligjit nr.04/L-144 për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, të nenin 4 të Rregullores QRK Nr.23/2013, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës, bazuar në kërkesën e Kryetarit të Komunës nr.01/466 datë:11.04.2017, në bazë të Statutit të Komunës së Malishevës nr.01/871 të datës: 12.11.2008, Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e IV (katërt) të mbajtur me datë: 28.04.2017, në vazhdimin e mbledhjes me datën:03.05.2017 mori këtë;

V E N D I M
NË PARIM PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM NË AFAT PREJ 1 (NJË) VITI TË PISHINËS
PUBLIKE NË FSHATIN BANJË

Neni 1

Miratohet kërkesa nr.01/466 datë: 11.04.2017 e Kryetarit të Komunës për dhënie në shfrytëzim në afat prej 1 (një) viti të Pishinës publike në Fshatin Banjë të Komunës së Malishevës.

Neni 2

Obligohet komisioni për vlerësimin e ofertave që në pajtim me nenin 7 të Ligjit nr.04/L-144, për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, dhe Rregulloren QRK Nr.23/2013, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës, t'i kryejnë procedurat e ankandit publik për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër.

Neni 3

Çmimi me u ulët i mundshëm për një vit caktohet të jetë 15,000€ (pesëmbëdhjetëmijë euro), ndërsa në procedurë të ankandit do të përzgjidhet oferta ekonomikisht më e favorshme për Komunën.

Neni 4

Mënyra e shfrytëzimit dhe menaxhimit të lokacionit të lartcekur me këtë vendim do të rregullohet sipas procedurave të parapara ligjore.

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës, përmes organeve kompetente.

Neni 6

Ky vendim do të hyjë në fuqi nga dita e miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës, përkatësisht pas plotësimit të kriterëve ligjore të parapara me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale në Republikën e Kosovës.

Vendimi iu dërgohet:
Arkivit të Komunës,
Drejtorive të KK-së
MAPL-së.

